



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**  
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**PROCESVERBAL I/2023**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 31.01.2023  
Ora: 10.00

---

**Prezentë në takim:**

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Besa Kuçi

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Enver Shabani

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Znj.Festë Kabashi

Z.Herolind Limaj

Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj.Habibe Bytyqi

Z.X heladin Sadika

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

### **REND DITE**

- 1. Dhënia e deklaratës së betimit e anëtarit që është zëvendësuar;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343, të datës 28.01.2022;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Suharekës;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin “Lulëkuqja me katër petale” të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2022;**
- 8. Informatë për aktivitetet e KKS-së, për 6 mujorin e dytë të vitit 2022;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

**Qëndrim Elshani** - grupi i asambleistëve të LVV-së në Suharekë ka inicuar nismëm për mbledhjen e nënshkrimeve për kërkesën për seancë të jashtëzakonshme për diskutim rreth çështjes së tatimit në pronë, konkretisht iniciativës tonë për faljen e tatimit në pronë në vlerën deri 100 euro për taksat paguesit e Komunës sonë. Fatkeqësisht kjo nismë e jona nuk ka gjet përkrahjen e mjaftueshme të anëtarëve të Kuvendit, madje as të kolegëve nga opozita. Andaj ne propozojmë që sot të hyjë si pikë shtesë në rend dite që të diskutohet për çështjen e faljes së tatimit në pronë deri në vlerën prej 100 eurove për tatim paguesit e Komunës sonë për vitin 2023. Ju bëjmë thirrje ta mbështesni.

**Kryesuesi** - i përshëndes anëtarët që nuk e kanë dhënë nëshkrimin sepse neve nuk na lejohet si Kuvend Komunal me i fal nga 100 euro. Është një tatim në pronë të cilin e përcakton niveli qendror dhe jo niveli lokal.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

**3 për, 17 kundër, 9 apstenime**  
**Nuk miratohet**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**26 për, 3 kundër**  
**Miratohet rendi i ditës**

**Pika 1. Dhënia e deklaratës së betimit e anëtarit që është zëvendësuar;**

Vullnet Luzhnica si anëtar më i ri i Asamblesë jep deklaratën e betimit.

## **Pika 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**Unanimisht Miratohet**

## **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitën e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Bulëza Kuçi** - ne në KPF kemi diskutuar për këtë pikë dhe kemi kërkuar një llogaridhënie ose një njoftim.

**Remzi Bajselmani** - Arta Hoti është profesore në shkollën "Skender Luarasi" në Suharekë dhe është prind në shkollën "Destan Bajraktari" dhe i plotëson disa kriteret. Ne kemi menduar se është e arsyeshme të jetë në këtë komision.

**Flamur Bytyçi** - a ka procesverbal që e kanë zgjedhur personin në fjalë këshilli i prindërve edhe pse ne nuk jemi kundër këtij emri.

**Bulëza Kuçi** - drejtor, sipas informatave që dhe, do të thotë ju e keni zgjedhur dhe jo këshilli i prindërve.

**Remzi Bajselmani** - ne e kemi propozuar dhe ju po e zgjedhni sot.

**Flamur Bytyçi** - nuk është propozim i juaj sepse ti po thua që është propozim i këshillit të prindërve.

**Kryesuesi** - është e njëjta e vitit të kaluar dhe pasi e kanë sjellë DKA, është anëtare e këshillit të prindërve.

**Flamur Bytyçi** - për deri sa nuk ka procesverbal, nuk mundesh me konstatuar që është përfaqësuese.

**Urim Suka** - nuk po dyshojmë asgjë të Arta Hoti. Me udhëzimin administrativ këtë propozim e bën këshilli i prindërve. Ne kërkojmë një letër që këshilli i prindërve e ka bërë këtë propozim. Ju nuk jeni fare serioz në trajtimin që kanë të bëjnë me ligjin. Dua ta pyes Kryetarin se si po ndihet ku ke filluar me i punësuar familjarët e tu, e plotëson me nota e suksese të larta nuk po i jepet shanca me u punësuar? Si po ndihesh ku në shkollën e Bllacës është hera e tretë që shpallet konkursi dhe nuk je në gjendje me zgjedhur drejtorin e shkollës.

**Remzi Bajselmani** - nuk kërkohet procesverbal. DKA e ka propozuar këtë komision dhe është e juaja me votuar dhe mos me votuar.

**Dardan Berisha** - nëse kërkohet procesverbal është mirë me sjellë dhe nëse nuk kërkohet ne jemi pro këtij vendimi. Është mirë të sjellin 2-3 propozime prej këshillit të prindërve dhe ne si anëtar të kuvendit e zgjedhim një.

**Remzi Bajselmani** - nuk e propozon këshilli i prindërve anëtarin e komisionit por DKA.

**Dardan Berisha** - në KPF është diskutuar dhe keni thënë që drejt për së drejti e zgjedhur këshilli i prindërve dhe në këtë rast po thotë që e propozon DKA. Se si e jep udhëzimi administrativ, e din drejtori dhe është në rregull por propozoj herave tjera të sjellin 2-3 propozime.

**Urim Suka** - pse nuk e keni futur edhe emrin e përfaqësuesit të ministrisë?

**Avni Bytyçi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që është e saktë ajo që tha drejtori.

**Bulëza Kuçi** - po i ndryshoni fjalët sepse në KPF ke thënë që e bje këshilli i prindërve. Po e mbuloni drejtorin, në rregull. Ne nuk jemi kundër individit por jemi të interesuar të dimë se si ka shkuar procedura.

**Avni Bytyçi** - nuk kam thënë dhe as nuk jam duke e mbrojtur drejtorin por dhashë sqarim ligjor.

DKA ka përgjegjësi ti propozoj tre. Forma dhe procedura se si i nxjerr është përgjegjësi e DKA-së.

**Selman Kolgeci** - a ka mbajtur takim me këshillin e prindërve? Nëse jo, hiqeni nga këshilli i prindërve dhe thoni që prej DKA-së edhe Arta Hoti.

**Laureta Tafaj** - Dardan, ke qen aty me fillim dhe ke mujt me kërkuar me i sjellë tre emra dhe jo sot me kërkuar sepse ti je bashkë me pozitën.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**17 për, 3 kundër, 10 apstenime  
Miratohet pika 3**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343, të datës 28.01.2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Flamur Bytyçi** - ju po thoni që ka dhënë dorëheqje por a ka ma mundësi me pas një procesverbal ose kërkesën e tij për dorëheqje.

**Kryetari** - ka marrë detyrë të re dhe ka shku në Viti dhe në vend të tij e kanë propozu Albert Demaj që ta përfaqësoj komunitetin katolik në Sallagrazhdë.

**Flamur Bytyçi** - formën e propozimit, a e keni marrë prej komunitetit apo e keni propozu ju?

**Kryetari** - jo, është propozim prej fshatit Sallagrazhdë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**17 për, 11 apstenime**

**Miratohet pika 4.**

**Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Flamur Bytyçi** - ne kemi një statut të Komunës që është në vitin 2008 dhe mbi bazën e saj janë formu dhe këshillat e fshatrave, dhe janë formu në bazë të propozimeve partiake dhe jo në bazë të udhëzimit administrative i cili është në vitin 2019. Ne nuk e kemi harmonizuar rregulloren. A biem në kundërshtim me këtë se si i kemi zgjedh dhe mos po e kthen ministria këtë vendim sikur rastin e shujtave për punëtorët e administratës? Kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor.

**Avni Bytyqi** - mbledhjen e fundit të vitit 2022 ka ardh raporti për zgjedhjen e Kryetarëve të fshatrave dhe unë mendoj që ky proces ka përfunduar dhe është zgjedh në harmoni dhe përpuethshmëri me rregulloren e 2012-tës dhe me udhëzimin administrative të pushtet lokal. Sa i përket çështjes së kompenzimit, rregullorja nuk e parashihet që komuna mund të kompenzojë këtë çështje mirëpo udhëzimi administrative i ministrisë së Pushtet lokal neni 13 e specifikon që Kuvendet e Komunës me një vendim të veçantë mund të nxjerrin pagesën për kompenzimin e kryetarëve të këshillave dhe specifikon edhe procedurën.

**Flamur Bytyçi** - për deri sa në rregullore nuk është e përfshirë, si ka me u vendos kjo? Pse nuk po e ndryshojmë rregulloren?

**Kryesuesi** - po e kalojmë këtë vendim e pastaj do ta shqyrtojmë.

**Flamur Bytyçi** - pse nuk e rregullojmë sepse në 2008 është e fundit.

**Avni Bytyqi** - udhëzimi administrativ kur ka qenë në debat publik, unë e kam kundërshtuar sepse mendoj që është diskriminues. Atëherë e kam njoftuar edhe Kryetarin se udhëzimi administrativ është diskriminues për arsye se e kufizon numrin e këshillave të fshatrave nëpër fshatra në territorin e Komunës tone. Ndërsa pjesën tjetër, rregullorja e specifikon mënyrën shumë mire se si të zgjedhën Kryetarët dhe këshillat e fshatrave.

**Flamur Bytyçi** - a na obligon ne ligji me ndryshu këtë?

**Avni Bytyqi** - Qeveria e Kosovës po nxjerr rregullore dhe udhëzimet administrative me një formë nuk janë shumë obligative .

**Alban Berisha** - me rastin e raportit të këshillave të fshatrave ka qenë dhe një rekomandim që të bëhet ndryshimi ose nxerrja e rregullores së re, por nuk po them për kompenzime sepse e meritojnë me u kompenzuar. Në cilësinë e juristit them që jemi vonë dhe kur vijnë zgjedhjet e reja për këshilla të fshatrave nuk kemi nevojë me pas mospërputhje mes vete në aspektin ligjor. Me ato që tha Flamuri pajtohem dhe duhet në mënyrë urgjente me marrë dhe me i kontrollu rregulloret dhe mos të punojmë me rregullore shumë të vjetra që realisht ka ndërru legjislacioni dhe ne jemi të obliguar brenda 6 muajsh me i harmonizuar të gjitha aktet nënligjore. Ju kisha lut Kryesues që këtu të sillni draft-rregullore ose draft-vendim në mënyrë që të diskutohet dhe jo ne me dal para aktit të kryer. Shprehjen votone ose mos e votoni, ju kisha lut ta shmangni.

**Flamur Bytyçi** - ne në parim jemi pro kryetarëve të fshatrave për me iu pagu pagesa,po i gjithë debati është se pse nuk po e ndërrojmë këtë rregullore dhe statutin e Komunës.

**Kryesuesi** - do ta shqyrtojmë dhe kemi mundësi ta sjellim në seancat tjera.

**Kymete Bajraktari** - ne si komision kemi punu me një rregullore dhe e kemi kry procesin dhe me anëtarët e komisionit jemi dakordu që pas procesit do të vazhdojmë me ndryshu rregulloren në vitin 2023.

**Vullnet Luzhnica** - Kërkoj një interpretim ligjor se a kanë të drejtë anërit e Kuvendit por dhe pjesa e ekzekutivit me qenë edhe kryetar fshatrash edhe pjesë e ekzekutivit dhe Kuvendit Komunal.

**Avni Bytyçi** - as rregullorja e Kuvendit por as udhëzimi administrative nuk e ndalon një veprim të tillë dhe besoj që nuk është konflikt interesi.

**Dardan Berisha**- nuk do të thotë që ne si komision i këshillit të fshatrave që duhet me qenë patjetër edhe anëtar të komisionit të cilët mundën me ndryshu rregulloren.Unë jam pro këtij projekt-vendimi sepse çdo kund ku kemi shku, pyetja e vetme ka qenë se a ka pagesa.

**Avni Bytyçi** - pavarësisht që e ka nxjerr ministria një udhëzim administrativ për kompenzimin e kryetarëve të fshatrave,asnjëherë nuk e ka ndalu ministria apo qeveria me bo kompenzimin e kryetarëve të fshatrave deri më sot.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Aziz Bytyçi** - trajtimi me themel i kësaj çështje kur vie puna te kompenzimi,më duket jasht kohe.Për harmonizimin e akteve juridike duhet me pas kapacitete profesionale.Rregullorja dhe statuti është e detyrueshme si aktet nënligjore të harmonizohen me ligj sepse qeveria nxjerr udhëzime çdo tre muaj.

**Urim Suka** - po shihet jo seriozitet se si i trajtoni ju temat.Ne po themi që kjo rregullore dhe mbi bazën e praktikave çka ka ndodh deri tash është mire me u rregullu,me u përshtat me udhëzimin dhe me pas sa ma të qartë herën tjetër.Sa i përket pagesave ne jemi për.Procesi i kryetarëve të fshatrave ende nuk është përmbyll në të gjitha fshatrat dhe lus komisionin që ta vazhdojë punën në ato vendbanime,ti përmbyll dhe të na raportojë .

**Shefket Kolgeci** - qëllimi i grupit tonë parlamentar është që kjo rregullore të rregullohet me një rregullore të Asamblesë Komunale.Shkaku se përzgjedhja e këshillave të fshatrave ka pas shumë probleme sepse dikun janë zgjedh me rregullore dhe dikun me udhëzimin administrativ.Sa i përket pagesës ne jemi për.

**Avni Bytyçi** - udhëzimi administrative nuk e specifikon procedurën se si zgjidhen,vetëm me rregullore kanë shku.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

#### Unanimisht Miratohet

#### **Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin “Lulëkuqja me katër petale” të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Jehona Rrafshi Lumi** -më lejoni që si kryetare e partisë Nisma Social Demokrate dega në Suharekë dhe si asambleiste e K.K. Suharekë ,që në nderim të gjithë atyre viktimave,ti përkujtojmë me një minute heshtje të gjitha viktimat e gjenocidit në Kosovë.

**Jehona Rrafshi Lumi** - siç është bërë e ditur,Qendra e gjenocidit në Kosovë “Plagë e hapur” e drejtuar nga veprimtari z.Bardhyl Mahmuti drejtuar institucioneve shtetërore si dhe forcave politike që Lulëkuqja me katër petale të bëhet symbol unik i gjenocidit në Kosovë.Nisma Social Demokrate përpos që e ka mbështetur publikisht,konstaton që jeni të vonuar si shoqëri në unifikimin e përkujtimit dhe vazhdimësisë së kauzës për zbardhjen e gjenocidit në Kosovë Prandaj si asambleiste mbështes plotësisht që kjo logo të jetë përkujtimore e gjenocidit në Kosovë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 6.

#### Unanimisht Miratohet

#### **Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Labinot Halitjaha** - buxheti në vitin 2022 ka ardh pak me vonesë dhe neve pak a shumë na ka kushtëzuar në punën tone.Si buxhet i planifikuar ka qenë 17.120.000 ndërsa si buxhet total është 18.750.000 me të hyrat vetanake që janë bartë nga viti 2021 në vitin 2022 dhe grandit i performances.Janë alokuar 18.612.628 euro dhe janë shpenzuar 18.020.858.Të hyrat vetanake janë afërsisht 1.800.000,ku nuk janë realizuar kënaqshëm si kemi menduar ne por janë realizuar si total 2.237.000 me denimet nga gjykata si dhe kamatat.Si buxhet total është shfrytëzu në vlerën 96.82 % ndërsa te të hyrat vetanake janë shfrytëzu 89.26 % dhe te investimet kapitale buxheti është shfrytëzu 91.95 %.

**Urim Suka** - Kur jemi te ky raport,unë do të përmend disa fakte që dëshmojnë paaftësinë tuaj për ekzekutivin e buxhetit dhe anashkalimin që ekzekutivi i ka bërë vendimeve të Asamblesë,keqplanifikimin e shkeljet ligjore që këtë pushtet e ka përcjell gjatë vitit 2022.Në këtë raport figuron që janë shpenzu 500 mijë euro për ndërtimin e kolektorit në “Rrugën Skënderbeu” por e vërteta është që në këtë rrugë as nuk kanë fillu punimet fare.Këto mjete janë shpenzuar në projekte tjera pa planifikim fare dhe pa miratimin e Asamblesë.Në këtë raport figuron që janë shpenzuar 148 mijë euro për ndërtimin dhe rregullimin e varrezave në Suharekë.Dua të di,ku mbetën ato mjete?Ku mbetën ato foto të famshme të projektit të varrezave që promovojë në face book gjatë fushatës?Pres sqarime nga ju. Në këtë raport figuron që janë shpenzuar 50 mijë euro për ndërtimin e rrugëve “Hut Halimi dhe Bajram Sylja” në Greikoc, por rrugët nuk janë të shtruara atje.Në këtë raport figuron që janë shpenzu 18 mijë euro për ndërtimin e rrugës “Fejz Koliq Gashi” me asfalt në Javor por kjo rrugë është shtruar në vitin 2021.Në këtë raport figuron që janë shpenzuar 25 mijë euro për ndërtimin e rrugëve “Agim Hajdari,Beteja e Gallushes,Rahman Bytyqi,Dy Gurët,Sejdi Bullaku dhe Demir Hamza”,por unë isha në Nishor,i pash këto rrugë dhe katër nga këto rrugë nuk ishin të shtruara, e çuditërisht ishin të shtruara dy rrugë tjera që nuk figurojnë as në kontratë e as në raport.Në këtë raport figuron që janë shpenzuar 70 mijë euro për ndërtimin e rrugëve “Rexhep Velia,Molika,Shaljanët-seg,Kovaqi,Tafa,Jetush Shala,Haxhi Shania” në Mushtisht, por këto rrugë nuk janë shtruar gjatë vitit 2022 dhe çuditërisht në Mushtisht kanë fillu disa rrugë që nuk figurojnë as në kontratë e as në raport por figurojnë në kokën tënde.Në këtë raport figuron që janë shpenzu 50 mijë euro për ndërtimin e zonave të gjelbëruara dhe rekreative në Komunë,ku figuron që përveq luleve janë mbjell afër 100 drunjë dekorativ.Kërkoj sqarime se ku janë mbjell këta drunjë?Në këtë raport figuron që janë shpenzu shumë mjete për kanalizime,ndriçime e sanime të rrugëve lokale por fatkeqësisht përkundër kësaj, problemet janë në të gjitha vendbanimet ku kam parë e marrë shqetësimet e banorëve për cilësinë e punimeve atje.Unë kam adresuar shumë herë problemet me ndriçim e kanalizim ku edhe sot janë këto probleme edhe për kundër që ju keni kontratë për rregullimin e këtyre problemeve.Kur është miratuar buxheti në vitin 2022 ka qenë e planifikuar ndërtimi i një fushe sportive dhe një segment i rrugës “Ymer Krasniqi” në Bllacë por e vërteta është që nuk janë ndërtuar as rruga e as fusha sportive.Në këtë raport figuron që 142 mijë euro kanë shku në suficit.Pra nuk janë shpenzuar dhe kanë shkur në qeveri.Poashtu në këtë raport figuron që rreth 1 milion euro nga të hyrat vetanake do të barten për shpenzim në vitin tjetër.Kjo tregon për paaftësinë e kësaj qeverisje për shpenzimin e parasë publike.Nëse nuk i besoni të gjeturave të mia,ju ftoj të vizitoni bashkë secilën prej tyre në teren dhe të njëjtën kohë,ju ftoj të votoni kundër këtë raport sepse me votën kundër do ti jepni një mundësi ndryshimit të kësaj logjike të mbrapsht qeverisëse.Grupi i kuvendarëve të LDK-së nuk e miraton këtë raport dhe do të bëjë gjithë përpjekjet që ti adresoj këto çështje në secilën mundësi që na jepet.

**Selman Kolgeci** - kam deklaruar se buxheti i vitit 2022 nuk është buxhet që synon të rregullojë mirëqenien e qytetarëve tonë por buxheti i miratuar për vitit 2022 është buxhet për larjet e hesapeve elektorale.Janë gjet disa here keqpërdorime që në emër të projekteve të përfunduara vite më pare po realizoni pagesa dhe po investoni nëpër oborre private dhe rrugë private.Nga kolegu jonë Urimi u cekën disa nga shumë projekte të cilat rezultojnë të përfunduara para shumë kohe,e në këtë raport rezultojnë se janë investuar e paguar në vitin 2022.Projektet i tillë është:Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në qytet, por këtë procedure të prokurimit ju e keni në OSHP dhe me datë 20 janar të këtij viti është nxjerr një vendim

që kjo procedurë të kthehet në rivlerësim dhe për të njëjtën procedurë ju i keni shpenzuar 42.998.Projektet tjetër është ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës te Antenat tek rrafshi dhe segmenti i rrugës Ali Loshi në Vraniq.Është hera e tretë që keni nënshkru kontratë për këtë rrugë dhe nuk e keni përfunduar asnjëherë dhe këtu në raportin e shpenzimit të administrimit të buxhetit keni raportua se e keni shpenzuar 49.430 dhe ju

lutem na tregoni se ku i keni shpenzuar këto mjete.Njejtë është edhe me ndërtimin e nënstacioneve të autobusëve. Si e shpjegoni që gjendja në teren është krejt ndryshe.Tani kur po e shqyrtojmë raportin e buxhetit e kuptojmë se sa i rëndësishëm ka qenë sikur ti kishim përpara edhe materialin të cilin e kam kërkuar muajin e kaluar,pra listen e projekteve kapitale me situacionet e pagesave që ta analizojmë më në hollësi buxhetin.Ne rreth një vit më parë kemi kërkuar që të filloj procedura e plotësimit dhe përditësimit të adresave dhe shqyrtimit të adresave për ankesa për zëvendësimin e emrave të rrugëve por ju këtë nuk e keni bërë edhe sot.Shqetësuese është që pjesën më të madhe të investimeve kapitale e keni realizuar pa projekte detale dhe dyshoj që po i bëni qëllimisht për të manipuluar më lehtë.Oborret dhe rrugët private që i ka investu Komuna me taksat e qytetarëve,a janë dhe a mund të jenë në shfrytëzim të të gjithë qytetarëve apo ato investime do ti përvetësojnë vetëm përfituesit. Ku po e gjeni këtë guxim me anashkalu listen e Asamblesë të miratune për buxhetin e vitit 2022? A keni guxim që ta formojmë një komision nga Asamblea që të verifikojmë projektet e realizuara në vitin 2022.

**Qëndrim Elshani** - nga shenimet shihet se në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022,shihet se teprica e të ardhurave ndaj të dalurave është në shumën prej 591.770 euro.Shuma prej 141.996 euro na paraqitet si suficit buxhetor gjatë vitit fiskal 2022 për arsye të mos shfrytëzimit të mjeteve të alokuara nga fondi burimor i Republikës së Kosovës.Me këtë konstatim nuk tregohet realiteti i suficitit vjetor pasi që mjetet prej 410.000 euro nga fondi burimor,me vemndim të Asamblesë e duke e dëmtuar bujqësinë janë bartur nga drejtoria e bujqësisë në projektin kapital “Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu” pasi ky pushtet nuk ka pasur ndonjë projekt për bujqësi.Duke dështuar kontrata dhe duke mos u realizuar ky projekt, e më pas Kryetari duke e parë dështimin dhe duke e ditë që këto mjete do të mbesin suficit ,pa vendim të Asamblesë por me aktvendime,këto mjete i shpërndau në këto projekte:në projektin Palestra sportive në Grekoc,në projektin Salla sportive në Skënder Luarasi,në projektin në disa rrugë lokale në Sopijë,në projektin e palestrës sportive 13 Qershori,dy projekte për kanalizime,projektin ndriçimi,në projektin në disa rrugë lokale në Dubrave dhe në projektin në disa rrugë lokale në Suharekë.Ne kërkojmë nga zyrtari ligjor që të na interpretojë këto aktvendime .

**Flamur Bytyçi** - si keni guxu me ia ndërru destinimin mjeteve për kolektor?Drejtori i Financave,a e din sa përqind ka të drejtë me ia ndërru Kryetari i Komunës destinimin mjeteve ?

**Reshat Selimaj** - desha të ndërlihem te Urim Suka i cili ngriti çështjen e dy rrugëve.Kontrata është dy vjeqare,është hap rruga dhe është shtrur zhavor e cila kontratë e ka një datë kur fillon dhe kur mbaron dhe në moment kur mbaron kontrata ty të jepet e drejta me ngrit këtë çështje.

**Urim Suka** - ma sjell kontratën pasi është dy vjeqare sepse unë e kam pa dhe lexu kontratën .

**Alban Berisha** - te të hyrat vetanake,te denimet e trafikut ka një dallim viti 2021 me vitin 2022,afërsisht 80 mijë euro më shumë.Kryetar,a je i kënaqur me këto denime?A është mangësi e jona që nuk kemi siguru parking shumë sespe e dim që shumica e denimeve vin prej parkingjeve.

**Kryetari** - për mua viti 2022 është më i sukseshmi në çdo aspekt.Është e vërtetë që lëndë kanë qenë në OSHP,Kolektori te rruga “Skënderbeu” dhe varrezat e qytetit.Është e vërtetë që një Kryetar para 31 tetorit,mund ti ndryshoj zotimet për arsye se kur është lënda në OSHP,mjetet shkojnë në suficit.Mirëpo asnjëherë nuk paguhen mjete pa kontrata zyrtare.Kolektori te rruga “Skënderbeu” në dy anët ka kanalizim që edhe më tutje ajo pjesë e shtetit nuk ka kanalizim dhe paret kanë shku te kanalizimi dhe që janë kontrata dy vjeqare.Te sallat sportive kemi kontratë dy vjeqare. Nuk pajtohem që kanë shku 137.000 suficit.Suficit kanë shku vetëm 37.000 euro për arsye se mjetet tjera janë grand i performacës dhe kontrata është deri në qershor dhe nuk humbin mjetet.Kryetari jep sqarime për këtë çështje.Alban,sa janë mbledhë dhe a je i kënaqur,nuk varet prej meje ajo punë.Ju kisha lut që në çdo dokument që dyshoni,janë organet e shtetit.Llogari i jap çdo kuj dhe llogari jap edhe para qytetarëve.Paret që destinohen për një fshat,nuk ka shancë me shku në fshatin tjetër.Te kanalizimet që përmendi Urimi,afër 10 milion euro duhet të punohet për ti kryer kanalizimet e fshatrave të Suharekës.Çdo kund ku ka pas nevojë kemi intervenu sa kemi pas mundësi. Në pranverë fillojmë.Edhe një here pu ju them që kanë qenë kontrata legjitime dy vjeqare.

**Liridon Fandaj** - për ato që tha Kryetari,ky raport bie poshtë.Nëse Kryetari thotë që s’ka suficit e në raport ka suficitë atëherë ky raport është bërë kot.

**Urim Suka** - Kryetari prap po këmbngul që është viti më i sukseshëm.E ke planifiku kolektorin dhe varrezat,si ke realizu.Ke planifiku projekte në vendbanime dhe asnjë nuk është duke u bërë me projekt por

krejt vendbanimet me një paramasë. Te varrezat e qytetit ju po thoni që është në OSHP por 148.000 euro sipas raportit që ka përgatit drejtorja juaj figurojnë që janë shpenzu dhe asgjë nuk është punu. Edhe te kolektori paret i ke shpenzu dhe me çfarë të drejte e ke shkel ligjin. Ti po thua 37 mijë euro suficit ndërsa raporti thotë 142 mijë euro janë suficit. Është serioze dhe unë uroj që ta ndëgjoj dikush këtë zë.

**Kryetari** - grand i performancës ka qenë 518.000 euro dhe është i ndarë në dy faza. 37.000 euro janë suficit, përafërsisht buxheti 18 milion euro dhe me grande e donacione 25 milion euro. Të hyrat vetanake barten. Kolektori ka me fillu dhe me u kry. Pronën publike nuk e prekim. Kryetari tutje jep sqarime rreth këtij projekti dhe thotë që ata që e menaxhojnë dhe që japin nënshkrimin e fundit e kanë përgjegjësinë.

**Selman Kolgeci** - Kryetari po thotë që jam transparent por nuk po thotë që jam i gatshëm që të formojmë një komision prej Asamblesë dhe me dal me i verifiku të gjitha investimet që janë bërë në vitin 2022. E di që Kryetari është në dijeni që lista e investimeve kapitale me situacionet e pagesave për vitin 2022 nuk na është dhënë sikur që nuk na është dhënë dokumentacioni i sheshit. Para disa muajsh ju keni dal, i keni kërcnu qytetarët tanë dhe keni thënë që taksat do ti mbledhni me përmbarues. Disa herë e kemi kërku listen e borgjlinjëve të Komunës dhe asnjëherë nuk e keni sjellë. Po ashtu po thoni që nuk e ndryshoj listën e investimeve por pikërisht këtë po e bëni. Po thoni që pronë publike nuk preki. Si po ndodhë ndërtimi i sallës sportive në shkollën “Skënder Luarasi” e cila është duke u ndërtu në pronë private.

**Kryetari** - ajo është kontest qe 20 vite, ai i ka pas kompenzimet dhe çka ka ndodh vendosin në gjykatë.

**Selman Kolgeci** - po thua që është kompenzu. A ka mundësi me e nxjerr fletën poseduese dhe me tregu në emër të kujt është?

**Kryetari** - nuk është çështje e imja. Kam një lutje për dokumentet që po i kërkon. Shkoni përmes zyrës ligjore, është protokoli dhe çdo gjë që kërkon keni me marrë.

**Urim Suka** - je mjeshtër i devijimit të debatit, Unë ngrita shumë çështje dhe asnjëherë nuk mi dhe përgjigje. Ke dështu në planifikimin që e ke bo dhe duhet ta pranosh.

**Kryetari** - asnjëherë në jetë skam deviju dhe as skam deviju. Merrne një dokument shtesë ku i keni paret para 31 tetorit kur janë vendos mi kry obligimet, kontratat dy vjeqare shkrun prej ku janë marrë dhe ku kanë shku. Janë kry obligime ndaj investitorëve të Komunës.

**Flamur Bytyqi** - kam mendu që në Komunën e Suharekës po bëhen shumë vizita të investitorëve të huaj por çdo javë ke hetues të agjensionit antikorrupsion. Çka po i bje kjo?

**Kryetari** - më vie mire. Jemi të hapur ndaj shtetit.

**Qëndrim Elshani** - kam kërku nga zyrtari ligjor interpretim për aktvendimet, për bartjen e mjeteve që i ka bërë Kryetari prej Kolektorit në rrugën Skënderbeu, për shkak se Asambleja i ka bartë këto mjetet prej bujqësisë e tash Kryetari i ka bart me aktvendime.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që Kryetarit të Komunës i lejohet deri 0.5 % të buxhetit të bart prej një kodi buxhetor në një kod buxhetor por jo te kodet buxhetore paga dhe medijtje.

**Alban Berisha** - Kryetar, unë e di që nuk është në kompetencën tënde dhe unë të pyeta se a je i kënaqur a jo dhe ti nuk më dhe përgjigje. A e sheh si një lloj dështimi të ofrimit të hapsirës.

**Kushtrim Kuçi** - Kryetar kam një lutje, pa marrë parasysh prej cilës do qeveri, që kur të bëjmë projekte e sidomos projekt kapital duhet ti kushtohet shumë rëndësi. Ne mburremi me sheshin e qytetit. Për këto lloj projekte duhet të hapet tender ndërkombëtar që me apliku gjithë byroprojektuesit e që del diçka shumë e bukur. P.sh. Malisheva ka gjet zgjidhje edhe për parkingje edhe për shesh ku edhe ne kemi mujt me bo diçka në atë drejtim. Nëse do të ishte bë një projekt i bukur që ky shesh posht me u shfrytëzu për lëvizje të makinave dhe lart si shesh.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 7.

**13 për, 12 kundër  
Miratohet pika 7.**

## **Pika 8. Informatë për aktivitetet e KKS-së, për 6 mujorin e dytë të vitit 2022;**

**Kryesuesi** - hap debatin për këtë pikë.



**Selman Kolgeci** - dua të ndalem te takimi i pestë i KKSBB-së ku në raport numrin e aksidenteve e keni thënë që është i njëjtë sikurse vitin e kaluar pa dhënë ndonjë shifër të saktë se sa është numri i aksidenteve. Poashtu keni thënë që policia e Kosovës do të marrë aksione për kontrollin e shpejtësisë, kontrole të vazhdueshme dhe zhblllokim të trotuareve. Kjo është detyrë e tyre dhe në këtë raport po e shoh që ju jeni pajtuar me numrin e aksidenteve dhe i keni lënë gjërat të rrjedhin normalisht, pa ndonjë strategji së paku komunale për parandalimin e aksidenteve. Poashtu vlen të theksohet se duhet të bëhet vlerësimi i rrugëve se sa ofrojnë siguri, sa janë të paisura me sinjalistikë të cilat i informojnë ngasësit për ndonjë rrezik në rrugë. Propozoj të hartoni një strategji lokale që do të ndikonte në parandalimin e aksidenteve.

**Kryetari** - ne jetojmë në këtë vend dhe jemi duke i pa gjanat. Ti je ekspert i kësaj lamië dhe e din. Kryetari flet rreth këtij problemi dhe thotë që nese bëjmë strategji, ju e dini që nuk është obligim i joni sepse e kontrollojnë policia. Sa i përket sinjalizimit, ke të drejtë. Kush ka mundësi me dhënë kontribut, le ta jep secili në laminë e vet.

**Selman Kolgeci** - unë jam i gatshëm çdo herë me dhënë kontribut pavarësisht që jam opozitë. Morre shembull rrugën Sopijë-Vraniq dhe është e vërtetë që ato elemente i mungojnë asaj rruge dhe pikërisht për këtë them që duhet të bëjmë një strategji.

**Alban Berisha** - dua të ndërlihem te mjetet piroteknike sepse me të vërtetë po abuzohet dhe po keqpërdoret. E di që ne si institucion Komunal nuk mundemi me i ndalu ato për importim por mundemi me bo një iniciativë në të ardhmen që të diskutohet bashkë sikurse ka qenë iniciativa për kazinot e që ka rezultu pozitive. E keni caktu një lokacion për shitjen e mjetetve piroteknike. A është respektu? Sa e di unë përveq barnatoreve në të gjitha lokalet është bërë shitja e tyre dhe mendoj që rrespektimi i atij rekomandimi ka qenë në nivelin zero.

**Kryetari** - drejtoria e inspeksionit së bashku me policinë kanë dalë dhe i kanë largu. Por deri sa i jepet licenca dikujt dhe i fut përmes doganes në mënyrë legjitime dhe shpërndahet nëpër komunat e Kosovës, ka me qenë problem çdo here. Ky vendim duhet të merret në nivel të parlamentit të R. Kosovës një herë e përgjithmonë.

**Alban Berisha** - unë e di që është e vështirë por nuk kam pa që ke marrë ndonjë masë. Kam dëshirë me tregu në seancën e ardhshme, sa denime ose tiketa i keni shqiptu për shitjen e pa vend të mjeteve piroteknike?

**Shefket Kolgeci** - çështjen e qenve endacak e kemi diskutu disa here dhe me të vërtetë është një shqetësim i qytetarëve. A ka mundësi qeveria komunale që të pakaten me gjet një buxhet, ta sjellni në kuvend dhe ne do ta përkrahim si Kuvend. Të ndahet një lokacion për mi sistemu qentë endacak dhe të përkujdeset dikush për ta. Kjo do të jetë e leverdisshme sepse punësohet dikush edhe i shpëtojmë fëmijët.

**Kryetari** - Kryetari thotë që disa here është analizu kjo çështje dhe tutje jep sqarimet.

## **Pika 9. Pyetje dhe përgjigje.**

**Urim Suka** - Pyetje për Drejtorinë e Arsimit: Sa është vlera e faturave që kanë mbet pa paguar për të gjitha shkollat dhe a mund të di se pse ka ndodh një dukuri e tillë sepse siç dihet është një dukuri e përsëritur. Edhe vitin e kaluar e kam bërë këtë pyetje. Pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë: gjatë këtij viti ju keni shpenzuar 23 mijë euro për ndërtimin dhe rregullimin e oborreve të QKMF-së - pjesa gjelbëruese, QMF-ve Bukosh dhe Studenqan dhe AMF Duhël dhe Leshan, Budakovë, Muhlan, Greikoc-mbjellja e drunjëve dekorativ. Në cilat nga këto institucione janë rregullu oborret dhe përkatësisht ku janë shpenzuar këto 23 mijë euro?

**Remzi Bajselmani** - nuk kam një përgjigje të saktë sepse nuk e di sa fatura kanë mbet pa pagu dhe pse nuk janë pagu, por e di që buxheti është hargju në mënyrë të rregullt. Shkolla e Bllacës nuk ka asnjë faturë të pa paguar ndërsa shkollat tjera nëse i kanë sjell faturat pas afatit, ato kanë mbet dhe për të cila mund të marrë informata nga zyrtarët financiar.

**Urim Suka** - nëse është mundësai përgjigjen që kërkova me sjell seancën e radhës ose edhe më herët.

**Remzi Bajselmani** - shumica e shkollave këtë vit kanë pas buxhet të shpenzuar për landën djegëse sepse është dyfishu çmimi dhe ndoshta kanë mbet faturat tjera por gjithësesi do kujdesem që të informoj.

**Besa Kuçi** - ky projekt u zhvillu në tri faza, ku kontratat i gjeni në zyrën e prokurimit së bashku me situacionet dhe pagesat. Është bërë rregullimi i oborrit në QKMF, ku është bërë mbjellja e luleve sezonale

dhe rregullimi brenda objektit të QKMF-së ku janë bo zhvendosja e disa garazheve.

**Urim Suka** - 23 mijë euro kanë shku për drunjë dekorativ,shporta dhe lule.Kjo është për keqardhje.

**Besa Kuçi** - unë e thashë që është një kontratë në zyrën e prokurimit dhe çdo gjë është transparente.

**Urim Suka** - këtu po figuron që në të gjitha qendrat ka mu investu ndërsa ti the që vetëm në QKM u investu.Dua të di se ku kanë shku këto 23 mijë euro dhe a jeni në dijeni që 10 pisha janë ble 1300 euro.

**Besa Kuçi** - nëse janë ble ato pisha,janë ble me kontratë të prokurimit.E jona është që nëse po figurojnë ato pisha që janë ble,ato pisha janë.

**Urim Suka** - unë nuk mora përgjigje.

**Jehona Rrafshi Lumi** - Pyetje për Drejtorinë e Arsimit: Duke pas parasysh që muaji për dhënien e bursave po afrohet, a është duke u punuar diçka lidhur me rregulloren e re për shkak se vitin e kaluar kemi has në disa kritere që na kanë penguar për dhënien e bursave? Nëse jo,ju sugjeroj që të punoni në këtë drejtim.Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike:Gizi gjerman ka sjell një donacion me disa kontinier për Komunën e Suharekës.Kur do të fillojë shpërndarja e tyre?Kërkoj që kërkesa e këshillit Bllacë të merret parasysh,që kontinierët e kërkuar të ndahen edhe për fshatin Bllacë.

**Qëndrim Elshani** - pajtohem plotësisht me kërkesën e Jehonën sa i përket rregullores për shpërndarjen e bursave.Propozoj që të formohet një komision prej Asamblesë ose të paktën të jetë ndonjë asamblesist pjesë e komisionit bashkë me një grup të DKA-së që me përpilu prej fillimit këtë rregullore.

**Kryetari** - nëse sot fillojmë,ju e dini që nuk bëhet sepse ka procedura por merrne inicitiv, formone.Këtë vit le të shkon sikurse çdo herë dhe mandej për çdo rregullore më të mire edhe për ne është më mire.

**Remzi Bajselmani** - I kam vërejt këto gabime dhe kemi punu në këtë drejtim.E kemi pru në Asamble 2-3 herë me rregullu por nuk ka pas vullnet.Edhe këtë vit jemi në procedurë dhe vullneti i Kryetarit ka qenë për me shtu numrin për bursistët.

**Enver Shabani** - kanë ardh rreth 500 kontinier si grand i performances prej Gizit gjerman dhe brenda javës do të fillojmë shpërndarjen e tyre dhe natyrtisht sipas kërkesës së Kryesisë së fshatit.

**Flamur Bytyqi** - u tha prej drejtorit dhe kolegëve që ka pas probleme në rregulloren për ndarjen e bursave.Unë në fillim thashë që ne duhet mi ndryshu këto rregullore.Të bëhemi bashkë dhe besoj që duhet me fillu sa s'është bë vonë.

**Elmaze Bytyqi** - Pyetje për Drejtorin e Arsimit: kohëve të fundit po shohim një valë të konkurseve për sekretar të shkollave në Komunën tonë.A po përfillet raporti konform numrit të nxënësve sipas normës së Ministrisë së Arsimit për numrin e shkollave? Sa duhet të jetë numri i përgjithshëm i sekretarëve në Komunën tonë?Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: E dime që me të mbaruar Zona Industriale kemi një deponi të mbeturinave inerte por të gjithë e dim që aty hudhen të gjitha llojet e mbeturinave dhe kjo e shton rrezikun e kontaminimit të tokës e bashkë me të edhe të ujit.Si pasojë e kësaj është rritur shqetësimi i banorëve të lagjes Sallauka dhe Gashi në Studenqan, se uji që po e përdorin mund të jetë i kontaminuar dhe si pasojë e kësaj deponie.A është ndërmarrë ndonjë veprim konkret në këtë drejtim?

**Kryetari** - më mire është të kontrollohet në një vend sepse më herët lumenjtë kanë qenë të mbushur plot,rrugë,rrugica e male.Në Kosovë është e vetmja Suhareka që e ka një deponi legale të mbeturinave.Kryetari tutje jep sqarime.Sa i përket bursave nuk e di kush ka qenë por asnjëherë nuk jam pëzier.

**Laureta Tafaj** - ne nuk thamë që ka pas padrejtësi në shpërndarjen e bursave por rregullorja i ka disa mangësi dhe atë po kërkojmë me ndryshu.P.sh. një nxënës që i ka dy prindërit pa punë, i merr 15 pikë ndërsa një nxënës që e ka njërin prind të vdekur dhe një të pa punë,nuk i vlen vërtetimi i papunësisë që me ja shtu disa pikë.

**Remzi Bajselmani** - unë jam përpjek pikërisht me ja dhënë bursën atyre që e meritojnë.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth çështjes së rregullores për shpërndarjen e bursave.

**Remzi Bajselmani** - ne kujdesemi me i zbatu udhëzimet administrative në fuqi.Rasti i fundit që e kemi pas,është që njëri sekretar është pensionu dhe njëri e ka lëshu punën me vetë dëshirë dhe i kemi plotësu si vende.

**Aziz Bytyqi** - sa i përket çështjes së rregullores,e ndaj shqetësimin me kolegë dhe pajtohem me Avniun sepse edhe një rregullore nëse e bën vet kur të fillon me zbatu e shesh që diçka tu ka shmang.Në 2018 e

kemi kriju një rregullore dhe në 2021 e kemi ndryshu. Projekti autentik si ka ardh nga komisioni është deformu. Unë jam i hapur mu marrë me atë rregullore por jo me punu me ngarkesa emocionale.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - pyetja ime është për komplet ekzekutivin por më shumë ndoshta i drejtohet detyrave të urbanizimit. Ka të bëjë me PZHK-në e cila është miratu për periudhën 2021-2029 dhe në bazë të ligjit për planifikim hapsinor dalin obligime që i takojnë autoritetit përgjegjës për planifikim, ku thotë që në baza vjetore Komuna ka për obligim që me monitoru dhe me raportu në Kuvend zbatimin e PZHK-së dhe çdo dokument tjetër planifikues që miratohet në Kuvend. Për periudhën e vitit 2022 neve nuk na ka ardhë asnjë raport i cili tregon se sa është zbatu PZHK. Kjo është shqetësuese dhe kërkoj të di nga Komuna se a janë duke e përgadit këtë raport me sjell në Kuvend për shkak se kanë pas obligim edhe me planifikim vjetor të Kuvendit që në dhjetor me sjell si dokument.

**Kryetari** - jemi duke e kriju një ekip nga të gjitha drejtoritë e cila e monitoron dhe në fund të vitit e bën një raport ku është realizu PZHK dhe ku ka pas probleme. Kryetari tutje jep sqarime.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - Nëse ka mundësi, nëse jo në seancën e muajit shkurt, atëherë më së largu në muajin mars me u sjell ky raport për shkak se është raportim për një vit.

**Kryetari** - unë jam këshillu dhe kam dasht me bo një komision që edhe një here ti shikojmë Hartat Zonale mirëpo MAPL ka thënë që nuk ke të drejtë me bo komision por çdo vit raporton në fund të vitit.

**Visar Kuçi** - siq tha dhe Kryetari, ne vendimin e kemi te Kryetari për formimin e grupit të monitorimit dhe veprimit. Nuk kemi bo raport për PZHK-në për shkak se PZHK në fakt e ka kalu një vit që është miratu por nuk u punu për shkak të HZK-së sepse Hartat Zonale kanë hy në fuqi në fund të vitit të kalaur. Jemi konsultu me MAPL-në dhe ska nevojë të bëhet raporti për PZHK-në sepse i njejt ekip ka me punu edhe në PZHK dhe për HZK. Besoj në fund të këtij viti ne kemi me përgatit raportin dhe kemi me dorzu dhe në Ministri të planifikimit.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - çështja e raportimit nuk besoj që lidhet komplet me HZK-në por janë disa pjesë të ndane që besoj që kanë fillu me u realizu në K. e Suharekës e që është mire me u raportu por edhe nëse keni pas pengesa në zbatim të PZHK-së për shkak të HZK-së, të paktën është desht një raport i thjeshtë dhe me na sqaru këtë problematik.

**Visar Kuçi** - jam komsultu me departamentin e planifikimit dhe më kanë thënë të vazhdoj prej këtij viti.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - mua më duket arsyetim jo me vend dhe insistoj që raportin e PZHK-së për vitin 2022 me e sjell më së largu në mars të këtij viti.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime sa i përket kësaj çështje.

**Selman Kolgeci** - Pyetje për drejtoreshën e Kulturës: para dy seancave një nga shqetësimet e mia drejtuar juve ishte lidhje me artin, respektivisht me disa projekt-propozime për të cilat i keni mohuar se kanë ardhë në tavolinë. A mund të na tregoni se një jvë e tillë kaq e madhe nuk është mbështetur nga ana e juaj si drejtori dhe a mund të na tregoni se a është organizuar java e artit në Suharekë? Pyetje për Kryesuesin: e kemi lënë përgjysmë debatin lidhur me rekrutimin e anëtarëve të bordit të Stacionit të autobusëve. Nëse përgjigja në këtë faze nuk do të pengonte procesin e hetimit do të dëshiroja të merrja përgjigje. Kryetari më rekomandon me i shkru Ministrisë së Arsimit për shkollën në Vraniq por ja që kam has në vesh të shurdhër këtu dhe atje. Në Asamble kam kërku disa herë që me u investu në varrezat e fshatit Vraniq. Te diskutimi i çështjes së bredhave, ne kemi pas ankesa përherë për zyrën e prokurimit andaj jo rastësisht zyra e prokurimit është në top 10 të autoriteteve ndaj të cilave bëhet ankesë.

**Kryetari** - pse çdo herë fajin ia lini Kryetarit. Vendimin e keni, toka është e ndane nga Asambleja komunale.

**Selman Kolgeci** - mire që po e pranoni që ka vendim. Në emision televiziv keni thënë që ska vendim. Kërkoj së paku pastrimin nga shkurret dhe rrethimin.

**Kryetari** - në shumë fshatra ka kërkesë dhe kemi intervenu vetëm në varrezat e fshatit Sallagrahdë me bashkëfinancim.

**Selman Kolgeci** - sa i përket bashkëfinancimit, jam i gatshëm që komplet pagat e Asamblesë me ti dhanë ty dhe me fillu.

**Kryesuesi** - sa i përket konkursit të stacionit të autobusave, çështja ende është duke u trajtu nga agjensioni kundër korrupsion.

**Flamur Bytyçi** - pyetje për Drejtorin e Pronës: Çka është duke ndodh në Zonën Industriale .me që kohën e fundit kemi shumë ankesa prej bizneseve për shkak që nuk kanë hapsirë ku me zhvillu aktivitetin e tyre

dhe sipas informatave që kam janë disa prona të cilat janë tjetërsu, disa janë lëshu me qera dhe disa janë duke u keqpërdor. Cili është hapi yt që ti e ke marrë si drejtor?

**Armend Krasniqi** - Zona Industriale është e paisur me 54 kontrata nga Komuna e Suharekës dhe këto biznese të cilat operojnë kanë një komision i cili është përgjegjës për zbatimin e këtyre kontratave.

**Flamur Bytyçi** - këtij komisioni a i prini ju dhe a jeni pjesë e tij.

**Armend Krasniqi** - jo.

**Flamur Bytyçi** - a keni marrë raport prej komisionit?

**Armend Krasniqi** - është direkt përgjegjës Kryetari për këtë komision. Ata i raportojnë Kryetarit. Janë 54 operatorë ekonomikë të cilët na kanë bërë krenar në atë zone për shkak të bizneseve të fuqishme të cilat i kanë instaluar. Natyrisht ka parregullësi dhe me siguri që nuk kanë mujt me i zbatu operatorët ekonomikë përgjegjësitë e kontratave për shkak të problemeve të ndryshme që kanë të cilat edhe ne në shtëpitë tona nuk mund ti zbatojmë 100 %. Mirëpo Kryetari ka kompetenca të ma tutjeshme se si vazhdohet.

**Flamur Bytyçi** - jam për mi ndihmu bizneset por nuk pajtohem me keqpërdor në Zonë Industriale.

**Kryetari** - si po mendon keqpërdor?

**Flamur Bytyçi** - ka raste që janë tjetërsu pronat. A është e vërtetë ?

**Kryezari** - po.

**Flamur Bytyçi** - pse s'po merr masa Kryetar ?

**Kryetari** - ligji e jep.

**Liridon Fandaj** - le ta interpreton zyrtari ligjor nëse ato kontrata janë të ligjshme.

**Flamur Bytyçi** - besoj që ka shumë ankesa edhe në Drejtorinë e pronës por edhe te ju që me ju nda një pronë sepse vet e ke premtu.

**Kryetari** - në moment që kalojnë Hartat Zonale dhe Plani Zhvillimor, nëse i fusim disa toka që kanë trashëgimi kulturore ,nuk aprovohen. Ne i kemi bo kërkesat në Ministri. Kryetari tutje jep sqarime.

**Flamur Bytyçi** - janë disa biznese që keqpërdorin Zonën Industriale. Pse s'po merrni masa. A ka të drejtë me ja shit pronën dikuj tjetër ?

**Kryetari** - biznesin ka të drejtë.

**Flamur Bytyçi** - kur do ta funksionalizoni Zonën e re. Kërkoj nga Drejtori me na sjell një raport për Zonën Industriale.

**Armend Krasniqi** - Drejtoria e Pronës është kompetente për me përgatit lejen e pronës për dhënie në shfrytëzim. Drejtori tutje jep sqarime.

**Flamur Bytyçi** - sa është numri i lokaleve që janë të lira për dhënie në shfrytëzim ?

**Armend Krasniqi** - nuk e di saktë por në muajin e ardhshëm kanë me dal të gjitha lokalet të cilat nuk kanë kontrata në Asamble.

**Flamur Bytyçi** - sa janë obligimet e qeramarrëzve të cilat nuk e kanë pagu Komunën dhe çfarë veprime keni marrë prej tyre të cilët e kanë këtë borgj kaq të madhë ?

**Labinot Halitjaha** - e kemi programin e financave dhe ky program për shkak të teknologjisë është djeg në muajin qershor dhe 4 muaj kemi pas problem me marrë licencë që ne me vazhdu përpara. Drejtori tutje jep sqarime.

**Flamur Bytyçi** - a keni nënshkru kontratë për rrënimin e objekteve dhe sa rrënimë janë kry deri tash.

**Kryetari** - po, kemi nënshkru kontratë dhe janë bë aq rrënimë sa kanë qenë të nevojshme.

**Flamur Bytyçi** - ju lutem përcjellja Drejtoreshës së Inspeksionit vërejtjen sepse ka dy muaj që ia kam kërkuar raportin.

**Laureta Tafaj** - 1. me datë 31.10.2022 me vendim të Kryetarit caktoheni mbikqyrës i drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës për ndërtimin e rrugëve Emërllah Hoxha ,Kolonja dhe 13 Korriku në Peqan. Ju si drejtor i Shërbimeve Publike shumë mirë e dini që ato rrugë kanë qenë të përfunduara. Pse keni pranë të jeni mbikqyrës i disa rrugëve të cilat kanë qenë të përfunduara ? 2. Në fshatin Vërshec me një oborr, në drejtim të rrugës Rust Kabashi janë shtru 50 m Asfalt. Ka 5 vite që të kam kërkuar për sanimin e disa rrugëve në fshatin Grejkoc. A nuk ke mujt me cilësu atë kërkesë timen për 5 vjet sepse qytetarët kanë nevojë dhe jo unë.

**Enver Shabani** - sa i përket fshatit Peqan për rrugën Emërllah Hoxha, unë jam mbikqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit por nuk jam i lidhur drejt për së drejti me kontratën, vetëm raportet i vlerësoj dhe i nënshkruaj. Sa

i përket Vërshecit rruga është e shtrune, është me kontratë dhe asgjë të keqe nuk ka. Sa i përket Greikocit, unë këtë vit nuk e kam menaxhu atë kontratë dhe nuk kam ndonjë përgjegjësi.

**Qëndrim Elshani** - pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë : pse nuk ka biokimist në QKMF-në në Suharekë kur e dim që laboratorët private obligohen dhe po denohen nëse nuk e kanë një të tillë.

**Kryetari** - e dini që dy herë kemi shpall konkurs për biokimist, dy herë kemi shpall konkurs për gjinekolog por nuk është lajmëruar askush. Kemi pas një bisedë me zëvendës ministren e shëndetësisë e cila ka thënë që do të mundohemi t'ju marrim licencën. Nuk do të lem me punë privat që japin licencat nëpër laboratorët private dhe do të mundësojmë që të punojnë nëpër qendra të mjekësisë familjare.

**Qëndrim Elshani** - sa janë rezultatet e sakta për deri sa nuk ka biokimist dhe kush i lexon ato ?

**Kryetari** - diagnozën e shikon mjeku sepse aty vendosen referencat.

Takimi përfundoi : 13 :25

Procesmbajtësja  
Dafina Haziraj